

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 50, 12 -18 Dhjetor 2016

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRES, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=2/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 50

	JAVA 50
DIARRE PA GJAK	1.132
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	9.876
INF. RESP. TE POSHTËME	5.241
RASH ME TEMPERATURË	31
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	399
% e Njësive Raportuese	93% (399/427)

Adresa: Rr. “A. Moisiu” Tirana, Albania, Tel. + 355 4 237 47 56 Fax. + 355 4 237 00 58. www.ishp.gov.al


Rash me temperaturë

19 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit, 3 raste nga rrethi i Kavajës, 1 rast nga rrethi i Vlorës dhe 8 raste nga rrethi i Tiranës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.


Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet 20% ritje në javën e 50 krahasuar me javën paraardhëse, java e 49.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet ritje në javën e 50 krahasuar me javën paraardhëse, java e 49.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 30 – 50 të vitit 2015 dhe 2016. Numri i rasteve.




Në javën e 50-të të vitit 2016 vërehet një trend në ritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 24% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 50-të të vitit 2016. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Ka rritje të numrit të rasteve të Infeksioneve Respiratore Akute (IRA) afër pragut epidemik.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 49 dhe 50 të vitit 2016. Incidenca (raste/10.000)




Vërejmë se thuajse të gjitha rrethet kanë një rritje të numrit të rasteve të IRA sidomos në Tiranë, Tropojë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Gramsh, Fier, Berat, Bulqizë, Devoll, Kuçovë, Mat, Mirditë.

Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 30 – 50 të vitit 2015 dhe 2016. Numri i rasteve.



Në javën e 49-të të vitit 2016 vërehet një trend në rritje të numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 2% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 49 dhe javën 50 të vitit 2016. Incidenca (raste/10.000)



Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 50 sipas rretheve, në përqindje.

